



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.171/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 26.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Anr.171/2025 e datës 24.01.2025 paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

A r s y e t i m

Me datë 24.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se kandidati për deputet dhe ministri aktual i kulturës Hajrulla Çeku me postimin e bërë me date 23.01.2025 ka shkelur nenin 34, par.1 nën par.1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku me rastin e postimit të një shkrimi në rrjetin social facebook, ku nder te tjerash subjektin politik LDK përmes nje gjuhe nxitëse e provokuese e ka quajtur “*Lodhja demokratike nuk kalon*”.

Si provë ka bashkangjitur postimin e z.Hajrulla Çekut në rrjetin social facebook.

Më datë 25.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 26.01.2025 subjekti politik LVV e mohon shkeljen e pretenduar dhe thekson se shprehjet e përdorura nuk hyjnë në kategorinë e gjuhës së urrejtjes apo fyese, dhe kërkon nga PZAP-i që e njëjta të refuzohet e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, sa i përket pretendimeve të parashtruesit se kandidati i LVV Hajrula Çeku ka përdorur shprehjet “*Lodhja demokratike nuk kalon*”, për Panelin këto pretendime janë të pabazuar dhe nuk mund të merret se kandidati i subjekti politik LVV ka shkelur nenin 34, pika 1.11 të LZP-në gjegjësisht se ka bërë thirrjet për nxitje të urrejtjes. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”,

Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lart.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.171/2025 më datë 26.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.